Vula

Shënim: Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të plotësojë këtë deklaratë.

⁴ Kjo deklaratë ka si qëllim plotësimin e kriterit ligjor që operatorit ekonomik brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nënkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura dhe/ose është shpallur fitues, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent

Shtojca 12

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*
- b. *Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1;*
- c. *Sigurim oferte, (nëse është e zbatueshme) sipas Shtojcës 3;*
- ç. *Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;*
- d. *Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;*
- dh. *Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës Shtojcës 8/1;*
- e. *Formular vlerësimi sipas Shtojcës 9;*
- f. *Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 10;*
- g. *Deklaratë mbi kontratat e lidhura apo ne proces, sipas Shtojcës 11;*
- gj. *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2.1. Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë:

Sipas Kriteve të përgjithshme të Pranim/Kualifikimit, pika 1 e shtojcës 12

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1- Kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit (2017, 2018 dhe 2019) vlera mesatare e se ciles të jete jo më e vogël se 50 % e vleres se fondit limit që prokurohet.

Në plotësimin e kësaj pike operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- a) Vertetim nga Dega e Tatim-Taksave per xhiron gjate tre viteve të fundit (2017, 2018 dhe 2019)
- b) Kopje të certifikuar të bilanceve për tre vitet e fundit (2017, 2018 dhe 2019), të paraqitur në autoritetet përkatëse dhe të konfirmuara prej tyre. Gjithashtu bilancet duhet të jene të shoqeruara nga akt ekspertiza e kryer nga Eksperti kontabel i autorizuar. (Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit).
- c) Operatori Ekonomik duhet të paraqese një deklaratë me shkrim nga administratori se subjekti nuk ka detyrime, ne vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitetet per vitet sipas QKB, 2018, 2019 dhe kestet e maturuara te vitit 2020 sipas afateve te percaktuara ne ligjin 9632/2006 ” Per sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Krahas deklarates te paraqiten dhe vertetimet perkatese.

2.3 Per kapacitetin teknik:

2.3.1 Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

- a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë sa 50% e vlerës së fondit limit, të realizuar gjatë tri viteve të fundit.

ose

- b) punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e kontratave të punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit është në një vlerë sa dyfishi i vlerës së fondit limit.

Plotesimi i njerit prej dy kushteve të sipërpermendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ku të shënohen vlera, koha dhe natyra e punës së bërë dhe çdo dokument tjetër, që parashikohet në legjislativën në fuqi, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

2.3.1/a Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Formularin e vlerësimit
2. Kontratën/Kontratën
3. Situacionin përfundimtar;
4. Aktin e kolaudimit;
5. Çertifikatën/certifikatat e marrjes në dorezim.
6. Faturat tatimore përkatëse për çdo situacion.
7. Kontrata e Bashkimit të Operatoreve të deklaruar në fazën e tenderimit si dhe marrëveshja e ndarjes së punimeve.
8. Prokura e posaçme e Bashkimit të Operatoreve të deklaruar në fazën e tenderimit.

2.3.1/b Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Formularin e vlerësimit
2. Kontratë;
3. Situacionin përfundimtar;
4. Faturat tatimore përkatëse për çdo situacion
5. Akt kolaudimi objekti;
6. Çertifikatën e marrjes në dorezim të objektit;

3. Liçenca Profesionale e Shoqërisë, për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuar nga autoritetet kompetente Shtetërore, sipas modelit të lëshuar nga MPPT/MTI në kategoritë:

1. NP – 1 C Punime gjurmimi në tokë
2. NP – 4 B Rrugë, autostrada, mbikalime, etj.
3. NP– 5 B Punime nëntokësore, ura e vepra arti.
4. NP – 7 D Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje
5. NP – 9 A Punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime.
6. NP – 11A Ndërtime për n/stacionet, kabinetat e transformatorëve, linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.
7. NP – 12 B Punime të Inxhinierisë së Mjedisit
8. NS – 5 A Impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut
9. NS – 6 A Sinjalistika rrugore jo ndriçuese
10. NS – 7 A Barriera dhe mbrojtje rrugore
11. NS – 9 B Punime strukturore speciale

Dokumenta Standarde të Tenderit

- 12. NS – 10 C Shtresa dhe mbistruktura special
- 13. NS – 14 A Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni, TV etj.
- 14. NS – 16 B Ndertim i impinateve te ujit te pijshem dhe pastrimit te tij
- 15. NS – 18 C Punime topogjeodezike
- 16. NS – 20 A Shpime gjeologo-inxhinierike , puse e shpime per uje

4. Drejtues Teknik i Shoqërisë të ketë në përbërje:

- | | |
|---|---------|
| 1. Inxhinier Ndertimi | 2 (nje) |
| 2. Inxhinier Hidroteknik | 1 (nje) |
| 3. Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder | 1 (një) |
| 4. Inxhinier Elektrik | 1 (një) |
| 5. Inxhinier Mjedisi | 1 (nje) |
| 6. Inxhinier Mekanik | 1 (nje) |
| 7. Inxhinier Gjeolog /Hidrogjeolog | 1 (nje) |

Secili prej pjestarëve të stafit teknik të mësipërm, duhet jetë i pasqyruar në Liçencën e Shoqërisë dhe Listëpagesat te paktën per 12 (dymbëdhjete) muajt e fundit nga data e zhvillimit te tenderit, te punesuar me kohe te plote ne Shoqeri. Te shoqeruara me dokumentacionin:

- Kontratë pune e vlefshme, Diploma, Libreza e Punes, CV
- (dy) nga inxhinierat e mesiperm te jene te pajisur me certificate per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit ne pune.
- (nje) nga inxhinierat e mesiperm te jete i pajisur me certificate pergjegjes demet ne mjedis
- (nje) nga inxhinierat e mesiperm te jete i pajisur me certificate Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis
- (nje) nga inxhinierat e mesiperm te jete i pajisur me certificate per parandalimin dhe mbrojtja nga zjarri
- (nje) nga inxhinierat e mesiperm te jete i pajisur me certificate ISO 9712-2012 “Testime jo-Shkaterruese- Kualifikimi dhe certifikimi i personelit NTD Direktiva Europiane 97/23/CE “Per enet nen presion”
- (nje) nga inxhinierat e mesiperm te jete i pajisur me certificate per testimin e performances se produkteve te ndertimit modul- Standart per sigurine e cilesise se produkteve te ndertimit.

5. Operatori ekonomik duhet të disponojë të paktën 25 punonjës të certifikuar me deshmi të sigurimit teknik lëshuar nga DPA ose Trupa certifikuese ekuivalente, në përputhje me zërat e punimeve në preventiv. Brenda kesaj liste duhet te deshmoje, dhe te figuroje ne listepagesa per 12 muajt e fundit:

- 1 Elektracist vërtetuar me kontratë pune të vlefshme si edhe të pajisur me Certifikatë/dëshmi/diploma përkatëse të kualifikimit Profesional lëshuar nga shkolla të mesme profesionale ose institucione jopublike, të akredituara në përputhje me legjislacionin në fuqi.

- 6 Hidraulik vërtetuar me kontratë pune të vlefshme si edhe të pajisur me Certifikatë/dëshmi/diploma përkatëse të kualifikimit Profesional lëshuar nga shkolla të mesme profesionale ose institucione jopublike, të akredituara në përputhje me legjislacionin në fuqi.
 - 2 Teknik ndërtimi vërtetuar me kontratë pune të vlefshme si edhe të pajisur me Certifikatë /dëshmi /diploma përkatëse të kualifikimit Profesional lëshuar nga shkolla të mesme profesionale ose institucione jopublike, të akredituara në përputhje me legjislacionin në fuqi.
 - 4 Specialistë për montim/saldim tubash HDPE shoqëruar me certifikatat/dëshmitë përkatëse
 - 1 Specialist për testimin e tubove nën presion HDPE.
- 6. Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të certifikuar me dëshmi të sigurimit Teknik:**
- 9 Manovratorë të mjeteve të rënda, vërtetuar me kontratë pune e cila duhet të jetë e vlefshme, dhe me Dëshmi Aftësimi Profesional të vlefshme.
 - 5 shofere vërtetuar me kontratë pune e cila duhet të jetë e vlefshme, dhe me Dëshmi Aftësimi Profesional të vlefshme.

Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/ çertifikuar si:

- 1 (një) punonjës i pajisur me çertifikatë “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- 1 (një) punonjës të disponojë çertifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".
- 1 (një) punonjës si "Përgjegjës për dëmet në mjedis" gjatë kryerjes së veprimtarisë, në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.

7. Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë të Administratorit të shoqërisë **Drejtuesin/(t) Teknik** të punimeve në objekt i cili do të jetë/jenë i/ të pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt dhe të jetë i pajisur me Diplomë, Kontratë pune.

8. **Operatori Ekonomik duhet të ketë një punësim mesatar i të paktën 90 punonjës me kohe të plotë për 12 (dymbëdhjete) muajt e fundit nga data e zhvillimit të tenderit, e vërtetuar kjo me:**

- a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për 12 (dymbëdhjete) muajt e fundit nga data e zhvillimit të tenderit.
- b) Listëpagesa nga Drejtoria Tatimore, sipas formularit E-SIG 025/a, të nënshkruara elektronikisht ose në hard copy.

9. Operatori/et ekonomike ofertues duhet të ketë në stafin e tij **1(një) mjek** në bazë të paragrafit 12/2 të VKM Nr. 692, datë 13.12.2001 “Për Masat e Vecanta të Sigurimit dhe Mbrojtjes së Shëndetit në Punë, i ndryshuar dhe të Ligjit Nr.10237, datë 18.02.2010 ”Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, VKM Nr.108, datë 9.2.2011 ” Për aftësi që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë” (i ndryshuar),

Për të cilin duhet të paraqiten:

- Kontratë individuale të punës e vlefshme
- Diplomë
- Urdhër Mjeku
- Të figurojnë në listëpagesën e shoqërisë për periudhën 12 (dymbëdhjete) muajt e fundit

Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

10. Operatori ekonomik te kete Liçense per Mbrojtjen nga Zjarri te lëshuar nga QKL.Kodi 1.2.A.

- a) Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar **1 (një) Ekspert zjarrëfikës**, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme dhe të pajisur me Liçensë për Mbrojtjen nga Zjarri të lëshuar nga QKL.

11. Operatori ekonomik te kete Liçence per Veprimtarite e ekspertizes ose kontrate bashkepunimi me nje subjekt Licencuar, lidhur me ndikimin ne mjedis (Auditim mjedisor ndikim ne mjedis) Kodi III.2.A (1+2).

- a) Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar, ose të kontraktuar të paktën **1 (një) Ekspert për vlerësimin e ndikimit në mjedis**, të vërtetuar me kontratë noteriale pune (të vlefshme) dhe të pajisur me Çertifikatën përkatëse.

12. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Liçence ose kontrate bashkepunimi me nje subjekt te licencuar, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit me Kod III.2.B. per Grumbullim dhe Transport te mbetje jo te rrezikshme.

13. Operatori ekonomik të paraqesë Çertifikata ISO te vlefshme:

- ISO 9001- 2015 (Sistemi i menaxhimit te cilesise).
- ISO 14001-2015 (Sistemi i menaxhimit te mjedisit)
- OHSAS 18001-2007(Sistemi i menaxhimit te shendetit dhe sigurise ne pune) ose ISO 45001-2018 (Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë).
- PASS 99:2012 (Sistem i integruar i menaxhimit).
- EN –ISO 3834-2 : 2006 (Çertifikate per sistemin e menaxhimit te cilesise ne saldim).
- ISO 39001: 2012 (Certifikate per sistemin menaxhimit te sigurise ne trafikun rrugor).
- SA 8000: 2014 – Per menaxhimin e Pergjegjesise Sociale

- ISO 28001:2007 – Per sistemin e menaxhimit te sigurise per zinxhirin e furnizimit
- ISO/ICE 27001: 2013 – Per menaxhimin e Sigurise se Informacionit
- ISO 50001:2018 – Per Sistemin e Menaxhimit te Energjise
- ISO 1452-1:2009 – Per sistemet e tubacioneve plastike per furnizime me uje, kullimiet dhe kanalizimet nentokesore dhe mbitokesore nen presion

14. Operatori ekonomik duhet te paraqese Autorizim Prodhuesi/distributori katalogjet ose fragmente te katalogjeve per

- a. Tubat plastike perkates pjese e preventivit
- b. Tubat e çelikut perkates pjese e preventivit
- c. Rakorderi/saracineska pjese e preventivit
- d. Matesa e ujit, sipas specifikimeve teknike te preventivit
- e. Impjant klorifikimi

shoqëruar me certifikatë ISO 9001:2015 të prodhuesit të mallit,

i. **Autorizim të prodhuesit/ve ose nga distributor i autorizuar prej prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi (ose ekuivalenti i tij/saj) të zyrtarizuar,** e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave lëshuar/ lidhur jo më parë se data e publikimit të procedurës së prokurimit. Autorizimi/ Marrëveshja bashkëpunimit duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

ii. **Katalogun/ët ose fragmente të katalogut/ëve e prodhuesit/ve** për listën e mësipërme, në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen.

Shënim: *Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin.*

iii. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë **dëshmi të testimeve zyrtare të kryera,** të lëshuara nga institucione të autorizuar ose nga prodhuesi, që vërtetojnë pajtueshmërinë e materialeve të prodhuara (lista e mësipërme) me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara

iv. Të gjitha materialet duhet të jenë sipas standerteve Europiane si dhe të prodhuara nga prodhues të çertifikuar me ISO 9001 dhe/ose të pajisur me Çertifikatë konformiteti për produktet e kërkuara.

15. Operatori ekonomik duhet te disponoj kontrate bashkpunimi me nje laborator te akredituar ne fushen e testimeve te materialeve te ndertimit ne perputhje me S SH ISO/IEC 17025:2006 e vertetuar me certifikaten e akreditimit nga organizmat akreditues , konkretisht ne testet e meposhtme.

- Percaktimi i forces ne shtypje e mostrave te testimi

Dokumenta Standarde të Tenderit

- Prova pa shkatërrim e mostres - percaktim i numrit te terheqjes
- Metodika e kryerjes se provave pa shkatërrim te betonit - Percaktimi i shpejtesise se impulsit ultrasonic
- Percaktimi i karakteristikave te boshlleqeve te mostrave bituminoze
- Percaktimi I trashesise se nje shtrese bituminoze
- Matja e temperatures
- Kontrolli I permasave te hekurit
- Rezistenca ne terheqje e hekurit
- Percaktimi i modulit te deformimit . Pjaster statike
- Percaktimi i modulit te deformimit dinamik
- Metodikat e kryerjes se provave pa shkatërrim te shtresave rrugore -Metoda e testimit per percaktimin e deformimeve
- Karakteristikat e siperfaqeve te rruges -Matja e profilit te terthorte dhe gjatesor te ashpersise dhe devijimit ne drejtim te valezimeve gjatesore - Llogaritja e Indeksit Nderkombetar te Rrjedhshmerise se Rrugeve

16. Operatori Ekonomik duhet te kete ne dispozicion apo qe mund t'i vihen ne dispozicion per te permbushur kontratën mjetet dhe makinerite e meposhtme.

Nr	Emri i mjetit	Njesi	Sasi	Statusi
1.	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtes jo me pak se 20 ton	Copë	5	Në pronësi ose me qera
2.	Kamion vetëshkarkues me kapacitet minimalisht 3 ton	Copë	3	Në pronësi ose me qera
3.	Kamion me vinç	Cope	2	Në pronësi ose me qera
4.	Eskavator me kove para kove mbrapa	Copë	4	Në pronësi ose me qera
5.	Eskavator me zinxhire	Cope	3	Në pronësi ose me qera
6.	Minieskavator	Cope	2	Në pronësi ose me qera
7.	Kamionçinë me kapacitet mbajtes jo me shume se 2 Ton	Copë	4	Në pronësi ose me qera
8.	Autobitumatriçe	Copë	1	Në pronësi ose me qera
9.	Asfalto-shtrues	Copë	1	Në pronësi ose me qera
10.	Rrul gome – hekur (kapaciteti jo më pak se 6 ton)	Copë	2	Në pronësi ose me qera
11.	Rrul hekur – hekur (kapaciteti jo më pak se 3 ton)	Copë	2	Në pronësi ose me qera
12.	Rul kompaktor ngjeshes	Cope	2	Në pronësi ose me qera
13.	Auto betoniere kantieri	Copë	1	Në pronësi ose me qera
14.	Rimorkiator	Copë	1	Në pronësi ose me qera
15.	Koke teheqese	Copë	1	Në pronësi ose me qera
16.	Matrapik	Copë	4	Në pronësi ose me qera
17.	Çekiç per thyerje inertesh	Cope	2	Në pronësi ose me qera
18.	Kompresor ajri	Copë	2	Në pronësi ose me qera

Dokumenta Standarde të Tenderit

19.	Moto Gjenerator	Cope	3	Në pronësi ose me qera
20.	Motosaldatriçe	Cope	2	Ne pronesi ose me qira
21.	Saldatriçe	Cope	3	Ne pronesi ose me qira
22.	Aparature elektronike per kontrollin e presionit , Pompe presioni deri 40 bar per te realizuar proceduren e testeve të presionit sipas EN 805.	Cope	2	Në pronësi ose me qera
23.	Aparat Saldimi me elektrofuzion	Cope	1	Ne pronesi ose me qira
24.	Aparat saldimi koke me koke	Cope	1	Ne pronesi ose me qira
25.	Aparat Saldimi per ngjitje te tubove PE	Cope	4	Ne pronesi ose me qira
26.	Autobot uji	Copë	1	Në pronësi ose me qera
27.	Freze asfalti	Copë	1	Në pronësi ose me qera
28.	Vibrator betoni	Copë	1	Në pronësi ose me qera
29.	GPS	Copë	2	Në pronësi ose me qera
30.	Kontrate furnizimi Fabrike asfalti	Copë	1	Në pronësi ose me qera ose kontrate furnizimi
31.	Kontenier stacioner (zyre ne objekt)	Cope	1	Në pronësi ose me qera
32.	Kokore	Copë	90	Në pronësi ose me qera
33.	Jelek	Copë	90	Në pronësi ose me qera
34.	Fikese zjarri	Copë	10	Në pronësi ose me qera
35.	Karroca dore	Copë	10	Në pronësi ose me qera
36.	Tabela sinjalizuese	Copë	20	Në pronësi ose me qera
37.	Kulle ndricimi Set	Set	1	Në pronësi ose me qera
38.	Prozhektore ndriçimi	Copë	3	Në pronësi ose me qera

- ✓ Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vertetojnë pronësinë e mjetit:
 - certifikatën e pronësisë;
 - leja e qarkullimit;
 - certifikatën e kontrollit teknik;
 - siguracionin;
 - leja e transportit;
 ndërsa për mjete të marra me qera krahas dokumentacionit të mesipër, duhet të paraqitet edhe kontrata e qerës e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të punimeve deri në përfundimin e plotë të punimeve.
- ✓ Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo zhdoganimit, fatura tatimore përkatëse, ndërsa për mjete të marra me qera krahas dokumentacionit të mesipër, duhet të paraqitet edhe kontrata e qerës e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të punimeve deri në përfundimin e plotë të punimeve.
- ✓ *Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata noteriale e qirasë me objektin përkatës e cila të përfshijë afatin e kërkuar për realizimin e kësaj kontrate.*

Dokumenta Standarde të Tenderit

- ✓ *Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas shtojcës Nr. 10. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).*
- ✓ *Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese deklarate që merr persiper realizimin e punes sipas Grafikut të punimeve (12 muaj nga nënshkrimi i kontrates).*
- ✓ *Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruar në procedurat të shpallura fitues nga autoriteti kontraktor (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronesi ose me qera me qëllim verifikimi).*

Operatorët ekonomik të interesuar për këtë procedurë prokurimi duhet të paraqiten me datë 05.03.2020 ora 12:00 pranë Sh.a Ujesjelles Kanalizime Bulqize për të bërë një vizitë në terren së bashku me stafin teknik të nderrmarrjes me qëllim njohjen e kushteve të ekzekutimit në terren të objektit. Operatori i interesuar Ekonomik duhet të konfirmojë paraprakisht me shkrim synimin e tij për të marrë pjesë në këtë vizitë. Gjatë vizitës do t'u jepen informacione shtesë e shpjegime.

Operatori ekonomik fitues në momentin e nënshkrimit të kontrates duhet të paraqese:

-Kopje të certifikates elektronike për Fiskalizimin, për tatimpaguesit që përdorin Platformen Qendrore të faturave

-Kopje të certifikates elektronike për fiskalizimin dhe kopje të vlefshme të kontrates së lidhur me Shoqërinë e certifikuar për zgjidhjen Software-ike në përdorim, për tatimpaguesit që leshojnë faturat nëpërmjet zgjidhjes Software-ike.

(të plotësohet nga autoriteti kontraktor)

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 13

(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)

PROJEKTI I ZBATIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE

Përshkrimi i të dhënave teknike të punëve objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Skicimet, Planimetritë e Objektivit etj:

Specifikimet Teknike të Materialeve:

Grafiku i Punimeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 14

(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)

PREVENTIVAT E PUNIMEVE

Shtojca 15

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDART PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR⁵

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar Z. /Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 Për Prokurimin Publik.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt
< **Emri** >

⁵ Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

Shtojca 16

[Shtojcë për t'u plotësuar Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data_____]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e

Dokumenta Standarde të Tenderit

shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 17

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia, objekti, kohëzgjatja e kontratës etj]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

2. _____

Dokumenta Standarde të Tenderit

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Perkatësisht për arsyt e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____ / _____
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____ / _____
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____
 (nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 18

KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS Punët – Procedura e Hapur

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Punëve të prokuruarra ne bazë të legjislacionit të prokurimit.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “Preventiv total” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotesuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.
- 2.2 “Preventiv per njesi” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njesi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.
- 2.3 “Afati i realizimit te punimeve” do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikon për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokures.
- 2.4 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.

Dokumenta Standarde të Tenderit

- 2.5 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.6 “Realizimi i punimeve” do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.
- 2.7 “Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.
- 2.8 “Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.
- 2.9 “Data e fillimit” është përfshirë në Të dhënat e kontrates. Ajo është data kur kontraktori do të fillojë punimet e ndertimit. Në se kjo nuk realizohet, “data e fillimit” do të jete dita në të cilën do të paguhet paradhenia.
- 2.10 “Pajisje” do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.
- 2.11 “Materiale” do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.
- 2.12 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.13 “Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.14 “Drejtues projekti” do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.
- 2.15 “Autoritet Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe që kontraktori punët objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.16 “Kantier” do të thotë vendi fizik i Punimeve.
- 2.17 “Raport i inspektimit të kantierit” do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.
- 2.18 “Nënkontraktues” do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.
- 2.19 “Kontraktor” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.
- 2.20 “Standarte Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

- 2.21 “Ngritja e kantierit” do të thotë punimet e ndërtimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluar, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndërtimit.
- 2.22 “Punime” do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të përkufizuara në dokumentat e tenderit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikrat e Korrupuara, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korrupuara. Veprimet e korrupuara përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktori duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktori mund t’i japë nënkontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar që nënkontraktorin të zbatojë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, kontraktori duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që premtun ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Prona Intellektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t’i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t’i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t’i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga kontraktori gjatë zbatimit

të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.

- 6.3 Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Materialeve

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.
- 7.3 Për qëllime verifikimi “origjinë” do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e kontraktorit ose nënkontraktorit që furnizon me materiale.

Neni 8: Vendimet e Drejtuesit të Projektit

- 8.1 Drejtuesi i projektit do të vendosë për çështjet e kontratës midis kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor
- 8.2 Drejtuesi i Projektit mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij tek të tjerët përveç zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe konflikteve. Drejtuesi i projektit duhet të njoftojë kontraktorin për delegimet e bëra apo të revokuara.

Neni 9: Komunikimi

- 9.1 Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

Neni 10: Bashkëpunimi në Kantier me të Tjerët

- 10.1 Kontraktori duhet të bashkëpunojë dhe të ndajë kantierin me firma të tjera, autoritete publike, shërbimet publike dhe Autoritetin Kontraktor siç kërkohet dhe përkufizohet në Grafikon e realizimit të punimeve.

Neni 11: Përgjegjësia e Autoritetit Kontraktor

- 11.1 Autoriteti Kontraktor ka përgjegjësi të kompensojë kontraktorin për dëmtime të pajisjeve të kontraktorit deri në masën që lidhet me veprime me faj të Autoritetit Kontraktor ose të projekteve të Autoritetit Kontraktor me perjashtim të rastit kur keto të fundit, kishin gabime të dukshme që mund të ishin konstatuar lehtësisht nga kontraktuesi.

Neni 12: Raporti i Inspektimit të Kantierit dhe Kushtet e Kantierit

- 12.1 Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për konkluzionet ose interpretimet e bëra në raportin e inspektimit të kantierit.
- 12.2 Kontraktori pranon se i ka marrë të gjitha hapat e nevojshme për të verifikuar natyrën dhe vendin e Punimeve dhe se ka inspektuar dhe pajtohet me kushtet e përgjithshme dhe lokale që mund të ndikojnë në kryerjen ose koston e Punëve.

Neni 13: Kontraktori që Kryen Punimet

- 13.1 Kontraktori duhet të kryejë dhe mbarojë Punimet në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit.
- 13.2 Kontraktori nuk mban përgjegjësi për gabimet në projekt, të dhëna, planimetri ose aspekte të tjera të specifikimeve teknike, të dhëna nga Autoriteti Kontraktor, me perjashtim të rasteve kur gabimi ishte aq i dukshëm sa kontraktori duhet ta kishte vënë re dhe ta kishte reklamuar këtë të Autoriteti Kontraktor.
- 13.3 Kodet dhe standartet që do zbatohen do të jenë të shprehura në dokumentat e tenderit. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në zbatimin e kodeve ose standarteve, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pasi të jenë aprovuar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 14: Ekzekutimi i Punimeve

- 14.1 Kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë sapo ta lidhe atë dhe duhet t'i mbarojë Punët brenda Afatit të Mbarimit.

Neni 15: Ngritja e Kantierit

- 15.1 Kontraktori mban përgjegjësi për projektin e Ngritjes së Kantierit.
